

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

Nr. 1351 Rep. Nr. 411 Kol./ 3

Tel. Zyre: + 4 2254506; Email: alma_noteri@yahoo.com



KONTRATË SHITJE

Në Tiranë, sot më datë 15 Qershor 2015 (dymije e pesëmbëdhjetë), dite e hënë, para meje Alma I. POSHI, Notere e Dhomes së Noterise Tirane, me seli në adresën: Rr. Sulejman Delvina, Nr. 57, Kodi Postar 1022, Tirane, u paraqitën palët e mëposhtme:

SHITËSI:

1. **Mirdita KONSTRUKSION Sh.p.k. Rreshen, Mirdite**, regjistruar me NIPT: J69102007K, përfaqësuar nga Administratori Pal PJETRI, i biri i Gjokes, lindur me 19-12-1957 ne Rras i Bute, banues ne Tirane, Rr. "F. Shiroka", mbajtes i dokument identifikimi Leternjoftim ID nr. personal F71219026Q,
2. **MALIDO Sh.p.k., Lezhe, Rreshen, prane ish-Ndermarrja Ndertimit**, regjistruar me NIPT: K38707048Q, përfaqësuar nga Administratori Gjovalin PRENGA, i biri i Gjonit, lindur me 07-06-1960 ne Mirdite, banues ne Tirane, Nj. B. Nr. 7, Rr. "M. Gjollështa", mbajtes i dokument identifikimi Leternjoftim ID nr. personal G00607072J,

dhe

BLERËSI:

KOJA Sh.p.k. Peze Helmes, Tirane, regjistruar me NIPT: K31505125A, përfaqësuar nga Administratori Fuat HAJDARI, i biri i Hashimit, lindur me 13 shkurt 1959 ne Peshkopi, banues ne Tirane, Peze-Helmes, mbajtes i dokument identifikimi Leternjoftim ID nr. Personal F90213095E

Te cilet kerkuan redaktimin e kesaj Kontrate shitje pasuri e luajtshme, kuota kapitali te Shoqerise "MALIDO-ENERGJI" sh.p.k. regjistruar me NIPT: K98824001D, me seli: Lezhe, Fan, KLOS Hidrocentrali Klos, prane Qendres se Komunes (në vijim referuar si "Shoqëria")

Së bashku në këtë kontratë referuar si "Palët".

Pasi verifikova statusin juridik të palëve, unë Noteri konstatova se palët e mësipërme janë me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar. Me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë ata kërkuar dhe ranë dakord me hartimin e kësaj Kontrate, në përputhje me legjislacionin shqiptar, sipas kushteve të mëposhtme.

Kushte paraprake

- 1.1 Shitësi MIRDITA KONSTRUKSION Sh.P.K. është zotërues i 270.528,00 pjesëve, me vlerë 2.705.280,00 Leke, që përfaqësojnë 16% të kapitalit të Shoqërisë MALIDO-ENERGJI SHPK;

- 1.2 Shitësi MALIDO Sh.P.K. është zotërues i 794.676,00 pjeseve, me vlerë 7.946.760,00 Leke, që përfaqësojnë 47% të kapitalit të Shoqërisë MALIDO-ENERGJI SHPK;
- 2.1 Blerësi KOJA Sh.P.K ka kryer të gjitha verifikimet e mundshme lidhur me kuotat që Shitësi zotëron në Shoqëri, si dhe me të drejtat e detyrimet që burojnë prej tyre.
- 3.1 Shitësi **MIRDITA KONSTRUKSION Sh.P.K.** dëshiron t'i shesë Blerësit pjesen e tij të zotëruar në Shoqëri, që përfaqësojnë **16% të kapitalit të Shoqërisë.**
- 3.2 Shitësi **MALIDO Sh.P.K.** dëshiron t'i shesë Blerësit nga pjesa e tij e zotëruar në Shoqëri, që përfaqësojnë 47% të kapitalit të Shoqërisë, **vetëm 20% të kapitalit të shoqërisë.**
- 4.1 Blerësi është dakort dhe pranon të blejë nga Shitësi MIRDITA KONSTRUKSION 16% dhe Shitësi MALIDO 20%, gjithsej 36% të kapitalit të Shoqërisë;
- 5.1 **Tranferimi i kuotave është miratuar nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë "MALIDO - ENERGJI" sh.p.k. me Vendim Nr. 13 date 11.06.2015.**
- ATËHERË, duke marrë parasysh sa më lart, për të cilat Palët janë dakord e nuk kanë pretendime, Palët bien dakord si vijon:*

Neni 1

Objekti i Kontratës/Kalimi i Kuotave

- 1.1 Duke pranuar afatet dhe kushtet e kësaj Kontrate, Shitësi i shet Blerësit dhe Blerësi i blen Shitësit, **36% të kuotave të Shoqërisë MALIDO-ENERGJI SHPK**, regjistruar me NIPT: K98824001D, të zotëruara nga Shitësi, dhe çdo të drejtë që buron prej tyre.
- 1.2 Kalimi i Kuotave të Shitura do të kryhet në përputhje me të gjithë ligjet dhe rregulloret e zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Çmimi i Shitjes

- 2.1 Çmimi i shitje ne total është **6.086.880,00** (gjashte milion e tetedhjetë e gjashte mijë e teteqind e tetedhjetë) LEK.
- 2.2 Palet deklaruan se Blerësi i ka paguar Shitësit për Kuotat e Shitura, "**Çmimin e Shitjes**" prej 6.086.880,00 (gjashte milion e tetedhjetë e gjashte mijë e teteqind e tetedhjetë) LEK, para nenshkrimit të kësaj kontrate, jashtë kësaj zyre noteriale.

Neni 3

Shpenzime

- 3.1 Taksat, tatimet dhe shpenzimet që lindin dhe rrjedhin nga kjo kontratë do të paguhet nga pala përkatëse mbi të cilën rëndon detyrimi sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 4

Deklarime dhe Garanci

- 4.1 Shitësi deklaron dhe i jep Blerësit të gjitha garancitë që parashikohen në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë për Shitësin, si dhe e garanton blerësin për gëzimin e qetë të titullit të pronësisë dhe vërtetësinë e dokumentacionit bashkëngjitur kësaj kontrate.

- 4.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi merr përsipër një detyrim të vlefshëm dhe të ekzekutueshëm ndaj tij në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.
- 4.3 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi pranon situatën e Shoqërisë, sipas gjendjes së faktit në të cilën ajo ndodhet dhe se asnjë pretendim i mëtejshëm nuk do të bëhet prej Blerësit në lidhje me këtë, përveç në rast shkeljes së ndonjë deklarate apo garancie të Shitësit sipas nenit 4.1, e cila nuk do të ketë rëndësi të pakët për interesat e Blerësit.
- 4.4 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Shitësi zvishet nga cdo e drejte dhe detyrim në lidhje me kuotat e tjetërsuara dhe çlirohet nga cdo lloj detyrimi dhe/ose përgjegjësie në lidhje me likuidimin e debive të shoqërisë. Blerësi deklaron se heq dorë shprehimisht nga cdo lloj pretendimi dhe veprimi përkundrejt Shitësit që rrjedh nga pagimi i debive të mësipërme dhe garanton gjithashtu se asnjë veprim do të ndërmerret prej Shoqërisë përkundrejt Shitësit në lidhje me këtë.
- 4.5 Blerësi do të çlirojë dhe do të mbajë të pacënuar Shitësin nga cdo përgjegjësi, dëm, pretendim të të tretëve ose humbje që do të rezultojë, ose që do të rrjedhi apo do të lidhet në cdo mënyrë nga shkelja e deklaratave dhe garancive të Blerësit dhe të Kontratës në përgjithësi.

Neni 5 Të ndryshme

- 5.1 Kjo kontratë përbën një detyrim të ligjshëm, të vlefshëm dhe detyrues. Detyrimet dhe të drejtat që burojnë nga kjo kontratë fillojnë efektet e tyre nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.
- 5.2 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi në termat ose paragrafe të veçantë të kësaj kontrate, do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit, që i shtyu palët të lidhin këtë kontratë.
- 5.3 Për çfarë nuk është parashikuar në këtë kontratë, zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar, përveç kushteve të vendosura në këtë marrëveshje, rënë dakort nga palët.
- 5.4 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate midis dy palëve, do të zgjidhen me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjelltë midis palëve, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 5.5 Kur midis palëve nuk arrihet zgjidhja e çështjeve me mirëkuptim dhe kontrata shkelet nga njera palë, pala tjetër i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Unë, Noteri pasi ua lexova me zë të lartë palëve këtë Kontratë dhe u sigurova për identitetin e tyre, konstatova se ata e gjejnë atë të rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe Unë i vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.

PALET

SHITËSI

Mirdita Konstruksion Sh.p.k

Perfaqesuar nga Administratori

MALIDO Sh.p.k

Perfaqesuar nga Administratori

BLERËSI

KOJA Sh.p.k

Perfaqesuar nga Administratori

NOTERI

VENDIM

Nr. 13 date 11.06.2015

**I Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme
te Ortakeve te Shoqerise "MALIDO - ENERGJI" sh.p.k.**

Në Klos, Fan, Lezhe, sot datë 11/06/2015 (dymijë e pesëmbëdhjetë), ditë e enjte, ora 9⁰⁰, në seline e Shoqërisë "Malido - Energji" Sh.p.k. në adresën Hidrocentrali **Klos, pranë Qendres Komunes Fan, Rrethi Mirditë, Qarku Lezhë**, u mbledh Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë "Malido - Energji" Sh.p.k. me pjesëmarrjen e ortakeve:

1. **MALIDO Sh.p.k., Rreshen**, regjistruar me NIPT: K38707048Q, perfaqesuar nga Administratori **Gjovalin PRENGA**, i biri i Gjonit, lindur me 07-06-1960 në Mirditë, banues në Tiranë, Nj. B. Nr. 7, Rr. "M. Gjollësja", mbajtes i dokument identifikimi Leternjoftim ID nr. personal G00607072J, në cilesinë e ortakut dhe zoteruesit të 794.676,00 pjesëve, të cilat perfaqesojnë 47% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;

2. **I-AS sh.p.k. Rreshen, Mirditë**, regjistruar me NIPT: J98926004Q, perfaqesuar nga Administratori **Ndue SHKURTI**, i biri i Gjonit, lindur me 17-06-1961 në Simon, Mirditë, banues në Tiranë, Nj. B. Nr. 7, Rr. Kavajes, Pallatet "Lana Park", mbajtes i dokument identifikimi Pasaporte ALB Nr. BD5294886 dhe nr. personal G10617062H, në cilesinë e ortakut dhe zoteruesit të 33.816,00 pjesëve, të cilat perfaqesojnë 20% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;

3. **Mirdita KONSTRUKSION Sh.p.k. Rreshen, Mirditë**, regjistruar me NIPT: J69102007K, perfaqesuar nga Administratori **Pal PJETRI**, i biri i Gjokes, lindur me 19-12-1957 në Rras i Bute, banues në Tiranë, Rr. "F. Shiroka", mbajtes i dokument identifikimi Leternjoftim ID nr. personal F71219026Q, në cilesinë e ortakut dhe zoteruesit të 270.528,00 pjesëve, të cilat perfaqesojnë 16% të kapitalit themeltar të Shoqërisë; dhe

4. **KOJA Sh.p.k. Peze Helmes, Tiranë**, regjistruar me NIPT: K31505125A, perfaqesuar nga Administratori **Fuat HAJDARI**, i biri i Hashimit, lindur me 13 shkurt 1959 në Peshkopi, banues në Tiranë, Peze-Helmes, mbajtes i dokument identifikimi Leternjoftim ID nr. Personal F90213095E, në cilesinë e ortakut dhe zoteruesit të 287.436,00 pjesëve, të cilat perfaqesojnë 17% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë "Malido - Energji" Sh.p.k. mori në shqyrtim pikat e rendit të dites, propozimin e ortakut "Mirdita Konstruksion" shpk. Per t'u larguar nga shoqëria dhe transferimin e kuotave dhe shitjen me akt noterial te:

1. 16% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "Mirdita Konstruksion" shpk. në favor të ortakut tjetër/KOJA shpk i cili është dakort me këte kalim kuotash; dhe
2. 20% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "MALIDO" shpk. në favor të ortakut tjetër/KOJA shpk i cili është dakort me këte kalim kuotash,

Në perfundim të mbledhjes Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë pasi diskutoi pikat e rendit të dites, në unanimitet të plote,

VENDOSI

- I. Transferimin e 16% te kuotave te Ortakut/Mirdita Konstruksion shpk te Ortaku/ KOJA shpk dhe me kete transferim kuotash Mirdita Konstruksion shpk largohet nga Shoqeria MALIDO-ENERGJI shpk;
- II. Transferimin e 20% te kuotave te Ortakut/MALIDO shpk te Ortaku/ KOJA shpk; dhe
- III. Ne perfundim te sa me siper pika 1 dhe 2 ortake te Shoqerise MALIDO-ENERGJI shpk. jane:
 1. Ortaku «KOJA» Shpk. zoterues i 53 % te kuotave te kapitalit te shoqerise;
 2. Ortaku «MALIDO» Shpk. zoterues i 27 % te kuotave te kapitalit te shoqerise;
 3. Ortaku «I-AS» Shpk. zoterues i 20% te kuotave te kapitalit te shoqerise.
- IV. Shitjen me akt noterial te 16% te kuotave te kapitalit themeltar te Ortakut «Mirdita Konstruksion» shpk., ortakut/ KOJA shpk, kundrejt vleres se kapitalit 2.705.280,00 leke;
- V. Shitjen me akt noterial te 20% te kuotave te kapitalit themeltar te Ortakut «MALIDO» shpk., ortakut/ KOJA shpk, kundrejt vleres se kapitalit 3.381.600,00 leke.
- VI. Depozitim e dokumentacionit te Mbledhjes se Pergjithshme te Ortakeve te Shoqerise «MALIDO – ENERGJI» sh.p.k. Nr. 13 date 11/6/2015, per pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne aktet e shoqerise dhe ne Qendren Kombetare te Regjistrimit brenda 30 diteve nga marrja e ketij vendimi.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Shoqeria «Malido» shpk.
Perfaqesuar nga Administratori

Gjergj B. Peci


Shoqeria «Mirdita Konstruksion» shpk.
Perfaqesuar nga Administratori

PAL PETRI


Shoqeria «I-AS» shpk.
perfaqesuar nga Administratori

NGUE


Shoqeria «Koja» shpk.
perfaqesuar nga Administratori

Luigj D. ...
